

Nr. 2643 Prot

Tiranë, më 02/08 2021

Lënda: **Mbi Treguesit për Kriteret Standarte të Cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021**

Drejtuar: **Z. Petrit AHMETI**
Kryetar
Enti Rregullator i Energjisë

I nderuar Z.Ahmeti,

OSSH sha, ne zbatim te Rregullores per kriteret standarte te cilesise se sherbimit te furnizimit dhe performances se sigurise se rrjetit te shperndarjes se energjise elektrike, Vendimit te Bordit të ERE-s, Nr.97/2021, "Mbi miratimin e Treguesve për Kriteret Standarte të Cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021", po ju dergon, ecurinë e zbatimit të Treguesve të Matjes së Cilësisë së Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të shpërndarjes për periudhen Janar 2021- Qeshor 2021 dhe pritshmerine total 2021. (Tabelat Bashkelidhur kesaj shkrese).

Sic kemi bere me dije ne menyre te vazhdueshme OSSH sha kryen rregjistrimin e ndërprerjeve, të gjata apo të shkurtra, nëpërmjet metodave qe disponon, nepermjet sistemit te rregjistrimit manual te vazhdueshmerise se sherbimit, duke funksionuar per te gjitha linjat TL, TM dhe TU të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe mban rregjistrin e ndërprerjeve, i cili permban

- a- Origjinën e ndërprerjes;
- b- Shkakun e ndërprerjes;
- c- Numrin e klienteve në TL të përfshirë në ndërprerje;
- d- Kohëzgjatjen e ndërprerjes për secilin klient në TL të përfshirë në ndërprerje;
- e- Numrin e klientëve në TM të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive;
- f- Kohëzgjatjen e ndërprerjes për secilin klient në TM, të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive;
- g- Numrin e klientëve në TU, të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive;
- h- Kohëzgjatjen e ndërprerjes për klientët në TU, të përfshirë në ndërprerje dhe numrin e tyre, sipas radhës së rilidhjes, të ndarë sipas kategorive;

i-Datën, orën dhe minutën e fillimit dhe përfundimit të ndërprerjes, për të gjithë klientët të përfshirë në ndërprerje.

j-Cdo ndërprerje e furnizimit me energji elektrike të konsumatorit, në sistemin e shpërndarjes, e cila zgjat më shumë se 10 minuta, konsiderohet ndërprerje e gjatë, e cila regjistrohet dhe perdoret ne llogaritjen e treguesve te performances SAIDI, SAIFI, koha e nevojshme per riparimin e sherbimit pas nje difekti, Energjia e pafurnizuar.

Struktura operative e OSSH sha realizon rregjistrimin e te gjithë llojeve te nderprerjeve **ne menyre manuale** ne tabelat EXEL te difekteve ne nivelet e tensionit TL, TM dhe TU, perpunon te dhenat per te llogaritur treguesit e kerkuar te performances sipas kerkesave te ERE.

Per te kuptuar vlerat e realizuar te treguesve te cilesise se furnizimit te rrjetit shperndares rendesi te vecante ka analiza e struktures se rrjetit shperndares i cili eshte i vecante per nga :

1. Numri i madh i niveleve e tensionit 35/10/6/20/04Kv.
2. Shkalla e larte e amortizimit **ne 70% te tij jane pajisje me moshe mesatare mbi 40vjet**
3. Nivel i ulet i kabllimit te rrjetit. Ne rrjetet 6Kv dhe 10Kv jane perkatesisht **5% dhe 14%**. Si i tille ky rrjet nuk mund te siguroje tregues te qendrueshme te cilesise se furnizimit
4. **Rrjeti 20 kV ze vetem 14%** te totalit te rrjetit shperndares elektrik dhe ka nivel kabllimi 93%.
5. Ne pjesen me te madhe te tij duke perjashtuar rrjetin ne qytet Tirane, Durres, pak ne Fier linjat jane radiale dhe ne zonat rurale dhe rurale te thelle me gjatesi shume te madhe.
6. Ne pjesen me te madhe te territorit te vendit shtrihet **rrjeti 6-10Kv i cili ze rreth 85% te totalit te rrjetit shperndares.**
7. **Numer i larte i kabinave ne rrjetin 6-10kV i cili ze 57% te totalit te kabinave te rrjetit shperndares.**
8. **Kabinat private te lidhura ne rrjet zene rreth 51% te numrit total te kabinave.** Perdoruesit private te ketyre kabinave nuk i mirembajne, operojne dhe shfrytezojne keto kabina sipas kerkesave te Kodit te Shperndarjes te Energjise Elektrike duke provokuar nderprerje, avari ne rrjet, vonesa ne rrikthimin e energjise, shkalle te ulet sigurie gjate operimit.
9. Perdoruesit e rrjetit te lidhur nder vite deri 2013 nuk kane plotesuar standartet e kerkuara te OSSH ne piken e lidhjes duke operuar me pajisje te cilat per me teper nuk i nenshtrohen asnje remonti.
10. Ne zonat rurale te thella ka linja te cilat jane ndertuar nga vete banoret dhe jane jashte kushteve teknike. Duke qene pjese integrale e rrjetit ato shpesh provokojne nderprerje dhe avari ne rrjetin shperndares.
11. Rritja e numrit te HEC-eve te vegjel ne zonat ku konsumi eshte i vogel e ka kthyer rrjetit shperndares te paafte te permbushe detyrimin sipas licences per sigurimin e shperndarjes .

Nga analiza e kryer per treguesit e periudhes Janar – Qershor 2021 rezulton se ne zonat Tirane, Durres, Vlore dhe Fier ku jane kryer investime ne rrjetin 20 kV dhe ate ABC treguesit e Cilesise jane relativisht te mire krahasuar me zonat e tjera.

- Nderprerjet ne rrjetin shperndares jane kryesisht ne zonat rurale te cilat zene rreth 80% ne rrjetin TM dhe 75% ne rrjetin TL.
- Rajonet Tirane, Durres, Fier jane rajonet me treguesit me te mire te cilesise se vazhdueshmerise se furnizimit,
- Rajoni Tirane ze peshen specifike me te madhe te nderprerjeve 24%
- Ne zonat urbane koha e rikthimit te energjise eshte me e madhe per shkak te veshtiresive ne te gjithë proceset qe ndiqen nga lokalizimi i difektit, riparimi, dhe niveli i kabllimit i cili ka veshtiresi ne gjetjen dhe riparimin e difekteve ne rrjetin kabllor.

Ne gjashtemujorin e pare te viti 2021 krahasuar me te njejten periudhe te vitit 2020, SAIDI dhe SAIFI ka pesuar rritje respektivisht me 17% dhe 18 %.

Perkeqesimi i treguesve eshte kryesisht ne zonat rurale ne rrjetin TL, TM, 6-10kV perkatesisht 38-34%, 33-38%, 34-39%, analize kjo qe argumenton paqendrueshmerine e rrjetit shperndares ndaj ne zonat rurale. Rrjeti shperndares ne keto zona eshte kryesisht rrjet ajror i amortizuar i niveleve te tensionit 35/6/10kV, nivele te cilat jane rekomanduar nga ana e konsulenteve te kompanise per tu zvendosuar gradualisht me nivelet e tensionit 110/20kV.

Sikurse e kemi permendur me lart nga viti ne vit permes kontrolleve te vazhdueshme, permiresimit dhe rritjes se kerkeses se strukturave te qendres dhe atyre rajonale eshte siguruar permiresimi i mbledhjes se informacionit ne terren (operimi, raportimi dhe rregjistrimi i nderprerjeve nga ana e dispecerive rajonale).

Ne rrjetin TL treguesit jane me afer vlerave reale, sepse ka disa mundesi monitorimi ne aparaturat matese ne Nst, rregjistrimit i tyre nga struktura e personelit operativ te nenstacioneve, Dispecerise Qendrore TL, sistemi SCADA per nenstacionet e Tiranes.

Ne rrjetin TM treguesit kane marzh gabimi me te madh sepse ky rrjet i cili operohet nga Dispecerite Rajonale TM/TU ka pak pika monitorimi. Rrjeti TM eshte i kontrolluar me parametrat e nestacioneve (ngarkesa e fidrave) por ne gjatesine e tij nuk ka asnje mundesi monitorimi te parametrave apo komutimeve me hapje te kabinave, thikave te linjave.

Nga ana e kompanise eshte rritur kerkesa dhe ne zonat urbane ka ardhur duke u permiresuar operimi, rregjistrim dhe raportimi i te gjithë nderprerjeve ndersa ne zonat rurale nderprerjet ne kabinat per shkaqe te shtuara edhe te mungeses se infrastruktures mbledhja e te dhenave (njoftimi i dispecerive per nderprerjet) eshte e veshtire duke deformuar treguesit e perlllogaritur te vazhdueshmerise se furnizimit.

Sikurse kemi argumetuar ne menyre te vazhdueshme, rrjeti shperndares eshte i paqendrueshme ndaj kushteve atmosferike ne vecanti ne zonat rurale dhe rurale te thella.

Periudha Janar-Qershor 2020-2021

	Total		Urban		Rural	
EMERTIMI	SAIFI	SAIDI	SAIFI	SAIDI	SAIFI	SAIDI
Total OSSH 2020	11.75	22.48	4.98	9.96	17.15	36.14
Total OSSH 2021	13.63	26.87	5.95	9.03	21.95	46.14

Numri i madh i nderprerjeve dhe kohezgjatja e tyre ne zonat rurale reflektohet ne treguesit shume te larte te cilesise se furnizimit te cilat ne rajone te vecante arrijne vlera maximale disa here me te medhenj se vlerat mesatare te realizuara nga rrjetit shperndares duke siguruar cilesi minimale te furnizimit me energji elektrike ne keto zona.

1. NDIKIMI NDRYSHIMEVE KLIMATERIKE NE PERFORMANCE E RRJETIT:

Janar-Qershor 2021				
Pesha specifike qe zene FM				
	Janar-Qershor 2020		Janar-Qershor 2021	
	SAIFI	SAIDI	SAIFI	SAIDI
Total	11.87	22.49	13.63	26.87
Total pa FM	10.91	19.67	9.75	14.90
FM	0.96	2.82	3.89	9.78

Ne vitin 2021 krahasuar me 2020 ka rritje te numrit te nderprerjeve te shkaktuara nga koha keqe, e cila eshte reflektuar me rritje te treguesve SAIFI dhe SAIDI rreth tre here me shume nga 7 % ne 22% ne peshen specifike qe zene nderprerjet nga Forca Madhore ne performance totale te rrjetit.

Ne zonat rurale ku dominon rrjeti ajror 6/10kV numri i nderprerjeve eshte ende i larte dhe ze rreth 76% tek totali i nderprerjeve duke sjelle rritje te ndjeshme ne treguesit e vazhdueshmerise se furnizimit total te rrjetit te shperndarjes.

Ne keto zona rrjeti eshte i amortizuar dhe i ekspozuar ndaj ndryshimeve klimaterike, gje qe reflektohet tek numri i madh i fidrave te demtuar gjate kohes se keqe (rreshje shiu te shoqeruar me ere te forte), rritja e peshes specifike qe zene nderprerjet e shkaktuara nga Forcat Madhore ne rrjetin shperndares.

Ne periudhen e Janar-Qershor 2021 krahasuar me Janar-Qershor 2020 eshte rritur rreth 71% ndikimi i Forces Madhore.

Ne nyjet e rrjetit shperndares te cilat ndikohen nga kushtet klimaterike si linja ajrore, linja 35kV, fidra, kabina perkeqesimi i treguesve eshte me i madh.

Dimri i sivjetshem ka patur 11 emergjenca klimaterike vetem gjate periudhes Janar-Mars ne ndryshim nga vitet e meparshme ku kemi patur 2-3 emergjenca ne vit.

2. ANALIZA E NUMRIT TE NDERPRERJEVE NE VARESI TE SHKAKUT

Referuar vitit 2020:

- Eshte rritur numri i nderprerjeve te shkaktuara Forcat Madhore nga 1694 ne 4390 pra 59%.
- Eshte rritur numri i nderprerjeve te shkaktuara nga te tretet 2 %
- Eshte ulur numri i nderprerjeve te shkaktuara ne pergjegjesi te OSSH nga 7858 nderprerje ne 6682 nderprerje, pra 15%.

Numri i nderprerjeve nga subjektet e treta vazhdon te jete e veshtire te percaktohet ne vecanti ne nivelin e tensionit TU, **numeri i cili nuk perfshin nderprerjet e shkaktuara nga kabinat private qe furnizojne popullate, sepse keto raste nuk jane te evidentuara ne tabelat e difekteve te Drejtorive Rajonale dhe sigurisht sikurse shpjeguem edhe ne procedura e llogaritjes se SAIDI dhe SAIFI keto raste kalojne si nderprerje te pergjegjesise se OSSH duke deformuar shkakuin e nderprerjes dhe renduar nderprerjet me origjine pergjegjesi e OSSH.**

Pra nderprerjet e shkaktuara nga te tretet e kabinave private popullate rregjistrohen si nderprerje te pergjegjesise se OSSH.

Efekti i tyre eshte i larte sepse kabinat private zene rreth 50% te totalit te kabinave te lidhura ne rrjetin shperndares te OSSH.

3. NDIKIMI I KABINAVE PRIVATE NE TREGUESIT E CILESISE

Me qellim qe OSSH-ja te operoje ne menyre efçente Sistemin e Shperndarjes dhe te realizoje siguri maksimale dhe Qendrushmeri te Sistemit te Shperndarjes, nevojitet qe klientet apo Perdoruesit e Sistemit te Shperndarjes t'i sigurojne OSSH-ës kordinimin e sigurise ne kufijte operative

Pergjegjesia e OSSH, ne lidhje me furnizimin e Perdoruesve te Sistemit te Shperndarjes me Energji Elektrike, perfundon ne piken ndarese kufitare te instalimeve ndermjet paleve, siç specifikohet ne marreveshjen per sherbimin e shperndarjes. Vendi dhe numri i pikave ndarese propozohet nga OSSH dhe vendoset me marreveshje te ndersjellte me Perdoruesin e SSH.

Perdoruesit e sistemit konsumatore apo prodhues kryesisht te lidhur ne rrjetin 35kV dhe ate te tensionit te mesem provokojne ne menyre te vazhdueshme nderprerje ne rrjetin shperndares dhe nuk zbatojne kerkesat e rregullores se Sigurimit dhe shfrytezimit teknik dhe Kodit te Shperndarjes se Energjise Elektrike duke u bere pengese per OSSH te permbushe detyrimin e sherbimit te shperndarjes se energjise ne menyre cilesore.

- **Subjektet private te lidhur ne rrjet**
- Mungesa e investimeve nga subjektet private ne drejtim te standartit te pajisjeve ne piken e lidhjes
- Difekte te shpeshta per shkak te amortizimit
- Moszbatimi kushteve te marreveshjes se lidhjes (Fuqi e instaluar, etj)
- Instalimi i pajisjeve ne piken e lidhjes ne shkelje te kerkesave te akt-marreveshjes.
- Shfrytezimi dhe operimi i subjekteve ne rrjet ne shkelje te kodeve te rrjetit(koordinimi i sigurise, mirembajtja)
- Mungesa e personelit operativ te afte per kryerjen e veprimeve operative sipas kerkesave te dispecerimit te rrjetit shperndares.

OSSH ka kryer investime ne rrjetin shperndares te saj dhe kabinat ne pronesi te saj por kabinat private te kategorive te ndryshme vazhdojne te mbeten nyje problematike ne rrjet duke ndikuar ne sigurine e operimit, shfrytezimit dhe furnizimit me energji elektrike te abonenteve.

Per sa mesiper per te vazhduar me evidentimin e efektit qe japin te tretet ne performance e rrjetit jane mare ne vleresim si meposhte:

1. **Performanca e fidrave te nje zone, duke grupuar fidrat me numer te ndryshem te kabinave private.**
2. **Performancen e fidrave ne zone industrial Kashar duke i grupuar sipas peshes specifike qe ze kapaciteti i instaluar i te treteve.**

Per kete rast eshte mare ne reference rajoni Tirane :

Jane kalkuluar treguesit SAIFI dhe SAIDI per fidra te ndryshem ne varesi te numrit te kabinave private duke i grupuar nga 0 kabina deri ne fidra me me shume se 30 kabina private.

Fillimisht jane grupuar fidrat me numer te ndryshem te kabinave sipas grupimeve : 0-5 kabina;5-10; 10-20kabina; 20-30 kabina; me shume se 30 kabina shoqeruar dhe me numrin e abonenteve qe ka cdo grupim

Fidrat me numrin e kabinave private mbi 20 kane numer te madh difektesh 2-3 here me shume pra mbi treguesit e performances se Tiranes dhe zene ne peshe specifike rreth 54% dhe 80%te asaj totale perkatesisht tek SAIDI dhe SAIFI.

Rreth 32% e abonenteve te Tiranes furnizohen nga fidra tek te cilet provokohen difekte (nderprerje)nga kabinat private, fidra qe kane me shume se 20 kabina.

Rritja e numrit te kabinave private con ne rritje te numrit te difekteve pra perkeqesim i treguesve te cilesise se furnizimit si numur nderprerje dhe kohezgjatje pa energji i cili eshte rezultat i provokimit te nderprerjeve nga kabinat private

Treguesit e realizuar ne vlerat e llogarituar mbartin marzh gabimi per arsyt e meposhteme:

- Sistemi i perdorur per vlersimin e vazhdueshmerise se furnizimit sikurse u shprehem ne pjesen e pare **“Sistemi i perdorur nga OSSH per rregjistrimin, perpunimin e te dhenave ne llogaritjen e treguesve te cilesise se rrjetit shperndares”** mbart risqe per marjen e rezultateve.

Peshen me te madhe ne marzhin e gabimit ne rrjetin e pamonitoruar do ta jape raportimi dhe mbledhja nga terreni:

- i te gjithë nderprerjeve ne rrjet, process i cili megjithë masat e mara per ta minimizuar vazhdon ende. Ky proces eshte veshtire te verifikohet kryesisht ne rrjetin TM – TU i cili nuk ka nyje per monitorim dhe kontroll.
 - Raportimi me telefon dhe me pas rregjistrimi ne librin e bisedimeve operative
 - Mungesa e infrastruktures, mungesa e valeve telefonike ne zona te ndryshme
- **Shmangiet e treguesve te realizuar nga ato te priteshme sipas tendences ne ulje, total/urban/rural gjate te njejtës periudhe te viteve te kaluara , nderkohe qe kete vit per shkak te kohes se keqe treguesit kane pesuar rritje, evidenton faktin e agumentuar nga ana jone ne te gjithë studimet e analizat e derguara mbi efektin e kushteve klimaterike.**

Vetem rrjeti SMART do te siguroje saktësi ne mbledhjen e informacionit qe perpunohet per llogaritjen e treguesve.

Siç identifikohet në studim ne periudhen **Janar-Qershor 2021** treguesit nuk kane ndjekur tendencen ne ulje qe kane pasur gjate periudhave vjetore, por kane pesuar rritje per shkak te kohes se keqe me gjithë masat tekniko-organizative te mara nga ana e OSSH gjate 11 emergjencave dhe gadishmerive ne periudhen Janar-Shkurt-Mars.

Pra indekset e cilësisë së furnizimit të rrjetit shpërndarës janë ende të paqëndrueshme, në vlera shumë të larta krahasuar me ato të vendeve europiane për shkaqet e mëposhtëme.

➤ **Kufizimeve teknike në rrjetin e shpërndarjes si:**

- Kufizimet dhe pengesat kryesore vijuese në funksionimin e rrjetit te shpërndarjes së OSSH mbetet operimi në nivelet e tensionit 35 kV, 10 kV dhe 6 kV ne menyre manuale dhe me pajisje tejet te amortizuar qe pasohet me numer te madh te difekteve, zëvendësimit me pajisje moderne do siguroje një shkallë më të lartë të automatizimit dhe kontrollit.
- Niveli i ulet i kabllimit ne rrjetin TM-TU. Niveli i tensionit 20 kV ende nuk është mbizotërues në rrjetin e përgjithshëm të shpërndarjes TM (shtrirja prej 10 kV dhe 6 kV është akoma më e lartë). Zgjerimi i tij i shpejtë dhe i konsiderueshëm do të zvogëlojë numrin e difekteve dhe pavaresine e tyre nga kushtet atmosferike.
- Sistemi i kabllimit te rrjetit TU (rrjetit ABC) është në përqindje të vogel në rrjetin e shpërndarjes e tensionit TU (shtrirja e linjave ajrore është akoma më e larte). Zëvendësimi i linjave TU me rrjetin ABC do të çojë drejt shpërndarjes së sigurtë te energjisë në cilësinë e duhur sipas normave të përcaktuara. Ndikimi do të reflektohet në atë sasiore dhe cilësore përmirësimi i furnizimit me energji për klientët fundorë si dhe në zvogëlimin e frekuencës së ndërprerjeve dhe humbjet e energjisë.

- Sasia e kabinave shtyllore TM / TU (kabina shtyllash) mbetet e lartë dhe gjendja e tyre e keqe që nuk përmbushin kërkesat e standarteve të qendrueshmërisë fizike, elektrike dhe korozionit.
- Pajisjet e instaluara ne rrjetin 6-10kV të amortizuar, janë shumë të paqëndrueshme pavaresisht mirembajtjes apo riparimit te nyjeve kritike nga ana jone, per shkak te amortizimit 50 vjecar, pertej jetëgjatësisë së tyre.
- Automatizimi i rrjetit të shpërndarjes është akoma i ulët.
Rritja e shkallës së automatizimit në kontrollimin dhe transmetimin e të dhënave në dispozicion në Qendrën Kombëtare Dispeçer të OSSH sha për monitorimin e statusit të pajisjeve, gjendjes së përgjithshme të rrjetit të shpërndarjes, parametrave të rrjetit si dhe për operacionet në distancë, do të zvogëlojë varësinë nga stafi .
- Kapacitete të uleta transformuese të rrjeti shpërndarës në shumë Rajone të vendit e theksuar kjo në nivelet e tensionit 6/10 kV, i cili zë pothuaj rreth 70% të kapaciteteve të rrjetit të OSSH sha.
- Predominim i rrjetave ajrore 35/10/6kV dhe 0.4kV qe zënë rreth 82 % të peshës specifike te rrjetit i ekspozuar ndaj ndryshimeve klimaterike, duke reflektuar qëndrueshmeri të ulët në ditët me rreshje, erë apo kushte ekstreme të motit, megjithë përmirësimin e dukshem ndër vite deri në 84%.
- Numri i defekteve në rrjet varet mjaft nga kushtet atmosferike. Për shembull, sasia e defekteve gjatë ditëve të lagështa (shi, mjegull, ere, bore, furtune etj.) shkon ne me shume se 50-100 fidra nga me pak se 2 fidra në ditë me kushte atmosferike normale.
Ky është një rezultat i nivelit të ulët të përdorimit të kabllimit, niveli i larte i amortizimit vecanerisht vlera te ulta te izolacionit per shkak te shfrytezimit pertej lifetime te tyre.
- Situata do të përmirësohet gradualisht bazuar në strategjinë e kalimit nga nenstacionet 110/35/20/10/6kV ne 110/20kV, nga rrjeti ajror 35-10-6 kV ne kabllor 20 kV, nga rrjeti ajror TU ne rrjetit kabllor ABC të tensionit të ulët .
Gjithsesi, treguesit e rrjetit 20 kV jane ende me vlerë shumë të lartë për sa i përket nivelit SAIFI për tensionin e mesëm (1-2 për klient në vit) në vendet europiane.
Arsyeja është mungesa e automatizimit (SCADA e rrjetave TL- TM eshte ende ne fillimet e veta), mbrojtja e rrjetave kabllor 20kV problematike e cila eshte ne diskutime per zgjidhje edhe me konsulentet e OSSH sha per kalimin nga sistemi me nul te izoluar ne ate te tokezuar .
- Gjendja e keqe teknike e rrjetit të shpërndarjes dhe përqindja e vogël e kabllorve jashtë qyteteve të mëdha janë faktorë që shkaktojnë numër të madhe defektesh dhe ndërprerje të gjata në kohë për furnizimin e klientit.
- **Mungesa e një sistemi të mirë zhvillimi për mbledhjen dhe kalkulimin e të dhënave të defekteve që u referohen furnizimit me energji të klientëve.**

OSSH sha rregjistron sistematikisht ndërprerjet e furnizimit me energji elektrike, të gjata ose të shkurtra, për të gjitha linjat TL, TM, TU në formë manuale në tabela EXEL me anën e së cilës është e pamundur kalkulimi i vlerave të performancës së furnizimit të abonentit i cili afektohet nga ndërprerjet në rrjetin TL/TM/TU në varësi të nivelit të tensionit ku është lidhur.

Për të siguruar besueshmërinë tek vlerat SAIDI dhe SAIFI shumica e vendeve evropiane mbështesin mbledhjen e të dhënave dhe rekomandojnë uniformitetin e sistemeve të mbledhjes së të dhënave në Evropë i cili do të lejoje krahasimin e vlerave të përcaktuara nga rregullatorët e energjise.

Strategjia e modernizimit të rrjetit do të sigurojë jo vetëm përmirësimin e treguesve por edhe besueshmërinë e tyre.

➤ **Mungesa e qëndrueshmërisë së performancës në :**

- Rrjetin shpërndarës 110-35-10-6-04 kV të amortizuar dhe në atë 20kV të ndërtuar para viteve 2013, kjo më e theksuar në zonat rurale dhe rurale të thella ku numri i difekteve është funksion i kushteve të motit. Gjate periudhes Janar-Mars 2021 ka luhate të vlerave për shkak të motit të keq që shoqëroi këtë periudhë , megjithë përpjekjet maksimale me marrjen e masave tekniko-organizative në 11 emergjencat e gadishmerite në drejtimin e shtabit qendror të OSSH me qëllim minimizimin e numrit të ndërprerjeve, kohës së rikthimit të energjisë, rikthimin e energjisë deri tek abonenti i fundit edhe në kushtet e motit ekstrem me bore, reshje, etj.

OSSH sha në ditët me mot të keq bën përpjekje maksimale për të garantuar rikthimin e furnizimit të energjisë elektrike të klientët duke operuar rrjetin me marrjen e të gjithë masave tekniko-organizative të përcaktuara në Planin e Gadishmerisë.

Një nga arsyet që punohet me këtë sistem është fakti që rrjeti ajror është totalisht i ekspozuar ndaj kushteve atmosferike që në ditë me reshje numri i abonentëve pa energji rritet deri në disa herë dhe në kushte ekstreme deri në 10 herë.

➤ **Situata e limituar nga ana financiare e viteve të fundit që ka kaluar kompania si pasojë e përkeqësimit të kushteve hidrike të prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë ka çuar në mungesë të investimeve të planifikuara për transformimin e rrjetit, dhe për më shumë në nyjet kritike në rrjet që ndikojnë edhe në qëndrueshmërinë e treguesve si pasojë e :**

- Amortizimi i rrjetit të SSH e cila në 81% të saj është e shtrirë në zonat rurale dhe rurale të thella me gjatësi të mëdha dhe me seksione nga më të ndryshme gjatë gjithë gjatësisë së shtrirjes së linjave.
- Gjendja teknike shumë e keqe në zonat rurale të thella , terren i vështirë, mungesa e infrastrukturës rrugore por numri i vogël i abonentëve janë faktorë që nuk janë në prioritet të investimeve të kompanisë.

- Rritja e gjenerimit të shpërndare në rrjetin shpërndarës kryesisht në atë rural dhe rural të thellë po bëhet një faktor i shtuar në përkeqesimin e cilesisë së furnizimit jo vetëm SAIDI/SAIFI por edhe nivelet e tensionit.
 - Linja 6-10-0.4kV shumë të gjata referuar standarteve deri në 120km, me disa degëzime që kalojnë në zona të ndryshme rurale dhe rurale të thella.
 - Mosha mesatare e rrjetit mbi 40 vjet ku shfrytëzimi i një pjese të konsiderueshme të tyre punojnë në regjim të mbingarkuar. Për shkak të infrastrukturës së vjetër dhe mbingarkesave të energjisë elektrike, me gjithë përmirësimet që u bënë në vitet 2016 pjesërisht gjatë 2018, hasi vështirësi në menaxhimin e rrjetit,
 - Nyjet transformuese në parkun e saj si OSSH në 40% të sasisë totale janë mbi 50 vjet në punë që do të thotë ato janë mbi “Life time teknik
- **Treguesit e pritshme për vitin 2021 referuar realizmeve të tyre në periudhën Janar-Qershor 2021 dhe në vecanti tremujori i parë nuk do të jenë në vlerat e caktuara në Vendimin e ERE Nr 97 dt 07.04.2021, vlera të cilat janë ato të realizuara në vitin 2020 gjatë të cilit sistemi ka qenë në situatë të emergjencave të demëve nga termeti 2019 dhe me pas të situatës së emergjencës shëndetsore COVID 19.**
- Në gjashtëmujorin e parë 2021 janë realizuara vlera më të larta se ato të gjashtëmujorit të parë 2020, duke mosndjekur tendencën në ulje ndër vite. Ndikimin më të madh në këtë rritje e kanë treguesit e realizuar në periudhën Janar-Mars 2021, periudhë në të cilën ka pasur 11 emergjencë për shkak të kushteve ekstreme klimaterike.**

OSSH sha gjatë vitit 2020, është fokusuar kryesisht vetëm në drejtim të mirëmbajtjes së rrjetit nisur edhe nga orientimi i dhënë nga ERE me shkresën Nr.604 prot, datë 30.03.2020.

Tarifat e shpërndarjes janë në fuqi prej vitit 2015, duke e kushtëzuar OSSH në punën e saj në drejtim të investimeve.

Persa i përket niveleve të tensionit dhe frekuencës të cilat janë përcaktuar në vendimin 97 të vitit 2021, është përcaktuar si në kodin e shpërndarjes ndërkohe OSSH sha gjendet në kushtet kur:

- ERE ka miratuar treguesit e cilësive për OST sha në muajin dhjetor 2020.

Miratimi i këtyre treguesve e vendos OSSH sha në vështirësi persa i përket detyrimeve që ka shoqëria me përdoruesit e saj. Sepse problematikat që lindin në kufi me OST sha reflektohen edhe në kufijte operative të vetë OSSH sha me përdoruesit e saj.

Kjo për arsye të mosperputhjes së niveleve të lejuara të tensionit ndërmjet OST sh sipas Kodit të Transmetimit dhe OSSH sha sipas Kodit të Shpërndarjes.

Pranë OSHEE GROUP sha janë regjistruar disa raste të ceshtjeve gjyqësore me objekt shpërblim demi pasuror të iniciuara nga të tretet kundër shoqërisë, për shkak të djegies së ambienteve, paisjeve, makinerive, produkteve të tyre.

Si shkaqe të ngjarjeve mbi të cilat inicohet edhe ngritja e pretendimeve të paditësave për kërkimin e shpërblimit të dëmit, të cilat hasen më shpesh gjatë proceseve gjyqësore, mund të renditen:

- Cilësia e furnizimit me energji elektrike jashtë normave të përcaktuara në kodin e shpërndarjes apo në kontratën e furnizimit me energji elektrike (mbitension, tension nën nivelin e përcaktuar, etj.)
- Lohatje të shpeshta të tensionit, furnizimi me tension operativ nën vlerat e lejuara, ndërprerje të shumta të furnizimit me energji elektrike dhe të gjitha këto anomali të furnizimit me energji në sasinë dhe cilësinë e kërkuar nga standarti, shkaktojnë shëndetshëm elektrike si pasojë e shpimit elektrik dhe termik të izolacionit të përcjellësve, kablove, pajisjeve të komandimit etj.
- Mosrespektimi i kushteve teknike që lidhen me sistemet mbrojtëse në rrjet (në nënstacion, kabina elektrike, në shtylla e linja elektrike, përcjellës etj.)

Vlerat e pretenduara dhe të perfituara nga subjektet (disa prej tyre). Arrijnë në vlera të konsiderueshme sic po i pasqyrojmë dhe më poshtë,

#	PALA E PADITUR	OBJEKTI I PADISË	VLERA E KËRKUAR LEKË	SHKALLA E GJYKIMIT	RREZULTATI I SHKALLËS SË PARË TË GJYKIMIT
1	OSHEE GROUP SH.A.	Shperblim demi pasuror	157,607,700.00	Gjykata e Larte	Pranuar
2	OSHEE GROUP SH.A.	Shperblim demi pasuror	240,000,000.00	Gjykata e Larte	Pranuar pjesërisht
3	OSHEE GROUP SH.A.	Shperblim demi pasuror	361,930,097.00	Gjykata e Rrethit	Ne proces
4	OSHEE GROUP SH.A, OSSH.SH.A, FSHU.SH.A	Shperblim Demi Pasuror	708,359,815.00	Gjykata e Rrethit	Në Proces
5	OSHEE GROUP SH.A.	Shperblim demi pasuror	408,000,000.00	Gjykata e Apelit	Pranuar pjesërisht
6	OSHEE GROUP SH.A.	Shperblim demi pasuror	283,102,903.00	Gjykata e Rrethit	Ne proces

Ne analizen e kryer per nivelet e tensionit rezulton se OSSH ka shume problem dhe koha prej 10 minuta e kufirit te nderprerjeve te gjata, ne mosrealizimin e te cilave ndikojne faktoret e meposhtem:

- Rrjeti shperndares i OSSH eshte ne operim dhe ne monitorim manual ne fazen kur Sistemi SCADA ka filluar dhe eshte ende ne zhvillim
- Rrjeti 35/10/6kV me nje periudhe te gjate te shfrytezimit , i amortizuar, me seksione te ndryshme ne gjate gjithë gjatesise duke kapërxyer disa fish normat, rregullat dhe standartet teknike.
- Nenstacionet 110/35/TM dhe 35/TM me shfrytezim 38-40 vjecar, me pajisje me izolacion te dobësuar dhe amortizuar , ne te cilet transformaret e fuqise nuk garantojne komutime, rregullime automatike te tensionit duke sjelle problem ne menaxhimin e sigurise sipas percaktimeve te Kodit te Shperndarjes.
- Sistemi me neuter te izoluar te pajisjeve 35kV, 10kV, 6kV i cili nuk shoqerohet me stakim nga lsh me token, sjell kohe vonesa ne nderprerjet e paplanifikuara, kjo per pamundesi te lokalizimit dhe percaktimit ne kohe reale te difektit dhe rikthimin e energjise tek pjesa tjeter e rrjetit. Ky fenomen eshte i shtrire ne te gjithë zonat e pergjegjesise te cdo Rajoni. Ne rajonet Tirane, Durres zhvillimi i investimeve strategjike edhe me minimizimin e niveleve te tensionit ne rrjet nga 110/35/20/10/6kV tek rrjeti 110/20kV ka cuar edhe ne zvogelimin e kohes mesatare te operimit ne kushte normale dhe avari, lokalizimin e shpejte te difektit, permiresimin e stabilitetit te tensionit.
- Ne OSSH 45% e kabinave jane private qe nuk menaxhohen dhe mirembahen nga OSSH, te cilat jane burim avarish dhe vonesash per kthimin e gadishmerise te rrjetit shperndares.
- Luhatje te vlerave te tensionit operativ te furnizuar nga OST ne kufijte e lidhjes, te cilat jane objekt I mosmarreshjeve ndermjet dy operateve ne percaktimet e Kodeve te rrjetit:
 - Gjate ndryshimit te skemave te furnizimit
 - Gjate periudhes se rritjes se prodhimit nga njesite gjeneruese te lidhura ne rrjetin e OST
- Ne rrjetin shperndares jane lidhur 140 njesi gjeneruese , te cilet performojne ne nivele te ulta ne zonat ku injektojne energji , duke u shoqeruar me nje perkeqesim te performances gati 10-fish ne raport me zonat e tjera ku nuk ka njesi gjeneruese, kjo pasi rrjeti shperndares ka qene i paplanifikuar dhe i papregatitur per injektimin e ketij kapaciteti prodhues i cili rritet nga viti ne vit pavaresisht limiteve qe ju jane vendosur ne marreshjen e lidhjes . Ne kushtet e ndryshimit te rregjimit te rrjetit shperndares te projektuar per rregjim pasiv ne rregjim aktiv, megjithe perpjekjet maximale te OSSH ne fazen studimore dhe ate te shfrytezimit jane te pashmangshme fenomenet e meposhteme:

- a) Luhatjet e tensionit mbi kufijte e lejuar
- b) Mbingarkese ne rrjetin shperndares

- c) Asimetri ndermjet fazeve
 - d) Cenim te sigurise se jetes se komunitetit dhe personelit operativ dhe remontues
 - e) Garantimi I furnizimit cilesor me energji elektrike te perdoruesve te rrjetit ne keto zona.
 - f) Garantimi I sigurise dhe qendrueshmerise se rrjetit shperndares.
- Terrenet e veshtira ne zonat e thella malore, shpesh mungesa e nderlidhjes sjell vonesa ne kryerjen e veprimeve operative.
- Gjendja e amortizuar e pajisjeve ne nenstacione con ne rritjen e kohes se rikthimit te energjise edhe ne nderprerjet e shkurtra, dhe per me teper ne nenstacionet zonave rurale te thella ne periudhen e temperaturave te ulta (OSSH ka 33 Nenstacione qe ndodh fenomeni I ngurtesimit te transmesioneve te komandimit te pajisjeve komutuese)
- Ne zonat e thella rurale, mungesa e infrastruktures krijon veshtiresi per personelin remontues ne kushte normale dhe ato te avarise dhe ne vecanti ne periudhen e rreshjeve. Nenstacionet qe shtrihen ne keto zona zene rreth 75% te gjithe nenstacioneve qe administrohen OSSH

Problemet e mesiperme ndikojne negativisht ne rikthimin e energjise tek konsumatori dhe bejne te domosdoshme rishikimin e kohes prej 10 minutash, e cila percakton nderprerjet e gjata.

Referuar analizes se bere te kohes mesatare te zgjatjes se nderprerjeve per manovrimet, rezulton se koha mesatare varion nga 16 minuta ne 26 minuta.

Problematikat ende te pazgjidhura qe ndikojne ne treguesit e performances jane edhe

- Rrjeti shperndares, sidomos ne zonat rurale ku jane lidhur edhe HEC-et qe furnizohen nga linja te gjata dhe radiale me pa mundesi te tjera furnizimi , vazhdon te amortizohet dhe si e tille nuk perballon ndryshimet e theksuara klimaterike qe jane shfaqur gjate vitit 2021

Per keto zona ne rastet e perkeqesimit te motit kompania ka vene ne zbatim planin e gadishmerise dhe ate te emergjencave i cili ka per qellim rikthimin sa me te shpejte te energjise deri tek abonenti i fundit ne rastet e demtimit te rrjetit shperndares si dhe marjen e masave te sigurise.

Pra rrjeti shperndares ne zonat rurale qe eshte kryesisht rrjet ajror i amortizuar vazhdon te kete qendrueshmeri te vogel e cila shfaqet me rritjen e numrit te difekteve ne linje dhe veshtiresine ne riparimin per shkak te mungeses se infrastruktures rrugore apo zenies se rrugeve nga rreshjet e bores, reshqitjet e dheut.

Nder faktoret e evidentuar qe ndikojne ne treguesit e furnizimit jane edhe problematikat me HEC-et.

- Shtimi i numrit te stakimit per shkak te te treteve demtime te rrjetit TM, stakime provokuara nga te tretet perfshire edhe HEC-et te cilet operojne ne shkelje te rregullores se sigurimit teknik, shkelin kushtet e mareveshjes se lidhjes .
 - Ne rrjetin shperndares te OSSH jane lidhur HEC-et shpesh jane burim i avarive, per shkak te demtimit te pajisjeve te tyre te instaluar ne rrjetin e shperndarjes , efektit te mbitensioneve ne rrjet, mbingarkese duke provokuar ckycje te rrjetit ne qe ne shume raste jane demtuar, per shkak te cilesise se tyre te dobet.
 - Veshtiresi paraqet komunikimi operativ me operatoret e HEC-eve te ndertuar ne zona te thella ku mungojne valet telefonike, qe sjell vonesa ne lokalizimin e difekteve apo ulje te sigurise ne pune te punonjesve oprative apo mirembajtes te kompanise tone.
4. Treguesit e vazhdueshmerise se furnizimit me energji elektrike te fidrave ku jane te lidhur H/C-et ,si dhe faktoret qe ndikojne ne kete performance.

Rrjeti shperndares ku jane lidhur H/Cet e vegjel ka tregues performance te perkeqesuar, kjo nen ndikimin e faktoreve te ndryshem ne vecanti rrjedhoje e pozicionit gjeografik ku jane ndertuar H/C-ete e vegjel te cilat jane zona te thelle rurale, nje pjese e te cilave u permenden edhe tek analiza e performances se rrjetit shperndares.

- **Gjendja e amortizuar e fidrave.**
- **Jane fidra ajrore , radiale pa mundesi rezervimi apo alternative furnizimi nga fidra te tjere.**
- **Zonat ku kalon rrjeti i perkasin zonave te thella rurale.**
- **Mungesa e investimeve per nje kohe te gjate, shpesh ka degezime te fidrave te sajuara nga vete banoret.**
- **Kalojne ne zona ku ka ulje te konsumit te energjise elektrike per shkak te levizjes se popullsise vitet e fundit drejt zonave te banuara dhe si te tilla nuk jane planifikuar investime ne planin afatshkurter.**
- **Zonat ku kalojne ne pergjithesi jane zona malore dhe linjat jane te ekpozuara ne ere te forte, rreshje shiu e bore, temperature te ulta, kushte keto qe provokojne difekte ne rrjet.**
- **Mungesa e infrastruktures rrugore ne keto zona rrit kohen per lokalizimin dhe riparimin e difekteve.**
- **Efektet negative te mbitensionit, mbingarkeses ne rrjet per shkak te prodhimit si dhe provokim i stakimeve nga rritja e prodhimit ne periudhen me rreshje.**
- **Mungesa e dispecerise per H/C-et e vegjel ndikon direkt ne vonesen ne kohe te zbatimit te urdherave te dhene per veprime operative, manovrime sipas normave teknike specifike dhe rregullave te sigurise.**

- Cilesia e tensionit ne zonat me burime gjeneruese

Jane mare ne analize nivelet e tensionit operativ 110/35/20/10/6Kv ne nenstacionet ku emetojne energji HEC-et e ndertuar ne keto zona.

Nga rregjistri i parametrave orare te nenstacioneve jane evidentuar vlerat maximale dhe minimale te tensioneve.

Nivelet e tensionit operativ ne nenstacionet e zonave me burime hidrike ne anen 110kV te furnizuara nga OST ne piken e lidhjes luhaten nga +17% ne -11%.

Vetem ne nenstacionet 110/20kV transformoret e fuqise jane me rregullatore te tensionit dhe jane te vendosur ne rregjim manual per shkak te luhatjeve te shpeshta te tensionit. Te gjithë transformoret e fuqise operojne me rregullim manual te tensionit me rregullatore te tensionit dhe ne pergjithesi kryhet rregullimi ne sezone apo ndryshime te skemave te rrjetit TL.

Ne nenstacionet e tjere 110/35/10/6kV transformoret e fuqise jane manuale dhe shume te amortizuar, duke siguruar vetem ndryshim te pozicionit te komutimeve ne sezone por ne pjesen me te madhe te transformoreve te fuqise rregullimi i tensionit eshte i pamundur per shkak te vleresimit te gjendjes teknike te komutatoreve me risk shume te larte, ku cdo nderhyrje per komutim mund te coje deri ne demtimin e transformatorit te fuqise.

Fenomeni i rritjes se tensioneve perhapet edhe ne nivelet e tensionit TU ku OSSH nuk ka asnje mundesi teknike per te garantuar nivelet e tensionit brenda kufijve te lejuar.

HEC-et e vegjel rekomandohen te lidhen si pjese integrale e fidrave me qellim qe te permiresojne humbjet e energjise, nivelin e tensionit dhe te konsumohet sa me afer vendit ku prodhohet kjo energji.

Tregues i shkalles se konsumit te energjise se prodhuar sa me afer vendit te prodhimit eshte koeficienti i depertimit , raporti midis energjise se prodhuar dhe asaj te konsumuar (W_p/W_{kons}) dhe rekomandohet te jete me i vogel se 1.33.

- **Shkalla e depertimit e llogaritur sipas rajoneve me burime hidrike .**

Ne zonat me burime hidrike konsumi i energjise eshte i vogel dhe ky reflektohet tek koef i rritur i depertimit nga 2-28. Pra energjia e prodhuar nuk konsumohet ne zonen ku prodhohet por transmetohet teprica ne rrjetin e transmetimit vlere e cila do te jete ne rritje me lidhjen e burimeve te tjera ne rrjeti shperndares. Ne keto zona energjia e prodhuar nga HEC-et do te shkoje per konsum ne rrjeti i OST-se.

Nisur nga sa me siper OSSH sha gjendet perpara nje situate ende te pastabilizuar persa i perket realizimit te treguesve te cilesise sipas rregullores.

Gjithashtu OSSH sha e sheh te nevojshme **krahas rishikimit teresor rregullores se cilesise ku te behet ndarja e qarte e cilesise se aksesit ne rrjetin e shperndarjes, cilesia e furnizimit dhe cilesia e ofrimit te shperbimit per klientet**, edhe ndryshimin e akteve te tjera nenligjore te cilat do te ndihmonin procesin si

- Kontrata e aksesit me perdoruesit
- Ndryshime ne marrveshjen e sherbimit te shperndarjes
- Rishikimi I Kodit te Matjes
- Rishikimi I Kodit te shperndarjes
- Rishikimi I Rregullores se Profileve te Standartizuara te ngarkeses
- Rishikimi I rregullores se demit ekonomik
- Tarifat e reja te shperndarjes
- Percaktimi I cmimit te energjise reaktive per perdoruesit ne tregun e lire
- Pergatitja e sistemeve te menxhimit te matjes on line
- Etj

Lind nevoja e percaktimit paraprakisht e nje metodologjie per rregjistrimin, perpunimin dhe prezantimin e treguesve te cilesise, si dhe percaktimin e menyres se kompensimit te klienteve ne rastet e mos realizimit te treguesve te cilesise se sherbimit, me projekte pilot, te dimensioneve te sondazheve per tipologjite e ndryshme, duke e zgjeruar dhe zonen e veprimit per te vleresuar te gjitha risqet e mundeshme.

Duke patur parasysh se rregjistrimi dhe perpunimi i treguesve te cilësisë bëhet në mënyrë manuale, është e rëndësishme të përfundojmë investimet dhe të implementojmë masat për rregjistrimin dhe identifikimin automatik të treguesve në mënyrë që të minimizojmë impaktin e faktorit njeri në monitorimin e treguesve

Mekanizmi i kompensimit duhet të rishikohet (neni 9, kompensimi i furnizuesit) dhe OSSH duhet të paguaj kompensim vetëm në raste kur kemi ankesë nga klienti fundor dhe kur kemi të bëjmë me dëme aktuale të shkaktuara tek klientet.

Gjithashtu persa i perket nenit 10 te rregullores per percaktimin e kompensimit te klientit fundor, do te kerkonim nga ana Juaj nje interpretim te ketij neni lidhur me menyren dhe sasine ku do te bazohet kompensimi i klientit, ne vlere monetare, cili do te jete kriteri i vleresimit monetar dhe ku do bazohet ne cilet parametra.

Duke patur parasysh se cilësia e shërbimit varet nga përforcimi dhe rikonstruksioni i sistemit të shpërndarjes, e cila kërkon një investim të konsiderueshëm, dhe bazuar ne eksperiencat e shoqerive europiane te sistemit te shperndarjes niveli i garantuar i cilësisë duhet të aplikohet në mënyrë të pershkallezuar sipas ndarjeve te niveleve te tensionit fillimisht 35kV dhe ne vijim 20kV; 10/6kV, kur te jene plotesuar gjithe kerkesat dhe parapergatitjet per implementimin e te gjithe elementeve te besueshmerise ne perputhje me standartet per te gjithe elementet te Matjes Smart dhe rrjetit

Smart cilat do të mbulohen edhe me ndryshimet e tarifave të shpërndarjes sipas metodologjive dhe vleresimeve perkatëse.

Ne perfundim të sa parashtruar e shikojmë të domosdoshme organizimin e një séance degjimore teknike me pjesmarrjen Tuaj dhe të perfaqësuesve të OSSH sh.a për të diskutuar në mënyrë të detajuar lidhur me problematikat e paraqitura në këtë shkresë, diskutimin dhe ndarjen e mendimeve për të arritur në konkluzione të qarta, reale dhe të mundshme nga ana e shoqërisë për zbatim.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin Tuaj,

Me konsideratë,

Adrian ÇELA

Administrator

OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE GROUP SH.A



Treguesit TL+TM+TU		Realizim 2020			Vlerat e realizuara Janar-Qershor 2021			Vlerat e priteshme vjetore 2021		
Emertimi	Njesi a Mate se	Total Rrjetit shperndar es	urbane	rurale	Total Rrjetit shperndar es	urbane	rurale	Total Rrjetit shperndar es	urbane	rurale
a. Energjia e Pa-Furnizuar (ENS) Vjetore MWh	mwh	51,246			28,192			77,810		
Cilesia e Frekuences		. Kufiri normal I operimit 49.8 48.0 deri 52.0Hz			. Kufiri normal I operimit 49.8 48.0 deri 52.0Hz			. Kufiri normal I operimit 49.8 48.0 deri 52.0Hz		
i. Cilesia e Tensionit (VQ)		Nominal	I ulet	I larte	Nominal	I ulet	I larte	Nominal	I ulet	I larte
		230	-30%	+13%	230	-30%	+13%	230	-30%	+13%
		400	-30%	+13%	400	-30%	+13%	400	-30%	+13%
		6000	-20%	+15%	6000	-20%	+15%	6000	-20%	+15%
		10000	-18%	+20%	10000	-18%	+20%	10000	-18%	+20%
		20000	-8%	+12%	20000	-8%	+12%	20000	-8%	+12%
		35000	-29%	+17%	35000	-29%	+17%	35000	-29%	+17%
		110000	-13%	+17%	110000	-13%	+17%	110000	-13%	+17%
f. Koha e Nevojshme per Kerkesat per Lidhje te Reja										
0-10 kw TU		20			20			20		
10-20 kw TU	dite	20			20			20		
21-50 kw TU	dite	30			30			30		
51-100 kw TU	dite	60			60			60		
TM	dite	60			60			60		
b. Periudha e Njoftimit te Nderprerjeve te Planifikuara ne Sistemin e Shperndarjes	ore	24			24			24		
g. Indeksi i Kohezgjatjes se Nderprerjeve Mesatare (SAIDI)	ore	47.17			26.87	9.03	46.14	69.85		
h. Indeksi i Frekuences se Nderprerjeve Mesatare (SAIFI)	nume r	25.08			13.63	5.90	21.95	35.44		
g. Koha e nevojshme per riparimin e sherbimit pas nje difekti ne sistemin e shperndarjes (TM+TU)		2.78			2.13			2.98		
TM 35kV	ore	1.73 1.77			2.78 1.81			3.33 1.65		
20kV	ore	1.34 1.70			1.58 1.72			2.21 2.40		
6-10kV	ore	2.54 2.74			3.02 3.31			4.22 4.63		
0.4 kV	ore	1.07 1.50			1.06 1.45			1.49 2.03		